

URDHËR
Nr. 432, datë 6.7.2018

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS ME KUSHT AGJENCISË ALBAUTOR, NË
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORËVE TË VEPRAVE
ARTISTIKE DHE LETRARE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shitesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133”, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; si dhe kërkesës së agjencisë ALBAUTOR për ripërtëritje të licencës nr. 2451 prot., datë 11.4.2018; të urdhrin të ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018, “Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim/ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ndryshuar me urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018”, si dhe legjislacionin në fuqi, “Për organizatat jofitimprurëse”,

URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së agjencisë ALBAUTOR si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare, me afat 3-vjeçar, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri, me kushtin që të depozitohet në fondin special, në zbatim të nenit 151/9, të ligjit nr. 35/2016, shuma prej 6,7 milionë lekësh, e konstatuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit të Financës, e cila nuk u është shpërndarë titullarëve të të drejtave.

2. Përmbushja e plotë e detyrimit që buron nga neni 132, i ligjit nr. 35/2016, për lidhjen e kontratave individuale me autorin, që agjencia përfaqëson.

3. Pikat 1 dhe 2 duhet të përmbushen brenda afatit 6-mujor, duke filluar nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

4. Mosrespektimi i pikave 1 dhe 2 të këtij urdhri, brenda afatit të përcaktuar, përbën kusht për heqjen e licencës.

5. Pas botimit në Fletoren Zyrtare të këtij urdhri për ripërtëritjen e licencës, agjencia është e detyruar të kryejë pagesën në vlerën prej 300.000 lekësh, e parashikuar në vendimin nr. 33, datë 18.1.2017, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.

6. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi